



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

Z. A. Vokshi

U R D H Ë R

Nr. 195, datë 14.8.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS, PËR
HARTIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË
“PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE QEVERISJEN
TRANSPARENTE”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale “Për luftën kundër korrupsionit dhe realizimin e qeverisjes transparente”, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI).
2. Grupi ndërministror i punës të kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - një zëvendësministër nga të gjitha ministrinë e linjës, i cili caktohet nga ministri përkatës;
 - drejtorin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave;
 - këshilltarin e Kryeministrit, për çështjet e antikorrupsionit;
 - drejtorin e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndihmës së Huaj.


3. Në mbledhjet e grupit ndërministror të punës marrin pjesë, sa herë që iu kërkohet, përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme dhe nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).
4. Në mbledhjet e grupit ndërministror të punës, në varësi të çështjeve që do të diskutohen, ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore dhe specialistë të fushës.
5. Grupi ndërministror i punës për strategjinë “Për luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjen transparente”, në mbështetje të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””, ka për detyrë:
 - bashkërendimin e punës për përgatitjen dhe hartimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër korrupsionit, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), sipas përcaktimeve strategjike të Task Forcën Antikorrupsion;
 - paraqitjen për miratim dhe rekomandimin e ndryshimeve strategjike në Task Forcës Antikorrupsion, nëpërmjet zëvendëskryeministrit;
 - monitorimin e punës së grupit teknik të punës, të krijuar sipas pikës 7, të këtij urdhri;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë së luftës kundër korrupsionit dhe vlerësimin e ndikimit të politikave, të zbatuara në përputhje me detyrat e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër korrupsionit të përgatitet dhe hartohet në përputhje me manualin “Për përgatitjen e strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale”, të miratuar me urdhrin nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit, “Për përgatitjen e strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”.

6. Zëvendëskryeministri ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësit ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin e punës.
7. Zëvendëskryeministri, me propozimin e anëtarëve të grupit ndërministror të punës, krijon, pas mbledhjes së parë, një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtorësh ose specialistësh, të nivelit të lartë, nga ministritë e institucionet pjesëmarrëse, i cili bashkërendohet nga ekipi teknik drejtues, i përbërë nga përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit, kabinetit të zëvendëskryeministrit, Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, në Këshillin e Ministrave.
8. Grupi teknik i punës është përgjegjës për:
 - a) bashkërendimin e finalizimit të dokumentit strategjik ndërsektorial për luftën kundër korrupsionit;
 - b) ndjekjen periodike të raportimit për zbatimin e strategjisë së luftës kundër korrupsionit, duke propozuar ndryshimet dhe përmirësimet e duhura.
9. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës, për hartimin e strategjisë për luftën kundër korrupsionit, përcaktohen nga zëvendëskryeministri, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
10. Ngarkohet zëvendëskryeministri që, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri, të sigurojë fillimin e veprimitarisë së grupit ndërministror të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA